

Në bazë të nenit 35, paragrafi 1 nënparagrafi 1.1, nenit 65 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, nr.77 / 16 gusht 2010), të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës / Nr. 10 / 03 prill 2017, Prishtinë) dhe në bazë të nenit 136 si dhe nenit 138, paragrafi 2 të Ligjit Nr. 10/L-026 për Shërbimet e Pagesave (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës Nr. 10 / 14 maj 2026), Bordi i Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës, në mbledhjen e mbajtur më 29 qershor 2026, miratoi këtë:

RREGULLORE PËR PERIUdhËN KALIMTARE PËR ZBATIMIN E LIGJIT NR. 10/L-026 PËR SHËRBIMET E PAGESAVE

Neni 1

Qëllimi dhe fushëveprimi

1. Qëllimi i kësaj rregullore është të përcaktojë periudhën kalimtare të zbatueshme për entitetet dhe personat që i nënshtrohen Ligjit Nr. 10/L-026 për shërbimet e pagesave - (Ligji për shërbimin e pagesave) për të përshtatur aktivitetet dhe operacionet e tyre me dispozitat e Ligjit për shërbimin e pagesave pas hyrjes së tij në fuqi, në kuadër të procesit të iniciuar nga Banka Qendrore e Republikës së Kosovës - (BQK) për të aplikuar në Këshillin Evropian të Pagesave për zgjerimin e fushëveprimit gjeografik të Zonës së Vetme të Pagesave në Euro në Kosovë dhe, rrjedhimisht mundësinë që ofruesit kombëtarë të shërbimeve të pagesave t'i bashkohen “Skemave SEPA”, siç përcaktohet në nenin 3 të kësaj rregulloreje.
2. Kjo rregullore zbatohet për të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave të licencuar, autorizuar ose regjistruar për të ofruar shërbime pagesash në Kosovë në pajtim me Ligjin për shërbimet e pagesave.

Neni 2

Përkufizimet

1. Termat dhe përkufizimet e përdorura në këtë Rregullore kanë të njëjtin kuptim si në Ligjin për shërbimet e pagesave dhe në Rregulloren e Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës për informatat që shoqërojnë transferet e fondeve dhe për përcaktimin e kërkesave për transferet e kredive dhe debitimet direkte në euro.
2. Përveç paragrafit 1 të këtij neni, për qëllim të zbatimit të kësaj rregulloreje, termat dhe shkurtesat e mëposhtme kanë kuptimin e mëposhtëm:
 - 2.1. **Bankë** – nënkupton një bankë siç përcaktohet në Ligjin Nr. 08/L-304 për bankat;
 - 2.2. **EPC** – nënkupton Këshillin Evropian të Pagesave;
 - 2.3. **SEPA** – nënkupton Zonën e Vetme të Pagesave në Euro;
 - 2.4. **Transferta SEPA** – nënkupton transaksionet e pagesave të kryera në skemat SEPA, tërësisht ose pjesërisht, dhe që do të jenë, sipas rregullave të këtyre skemave dhe/ose siç përcaktohet nga EPC-ja, subjekt i rregullave përkatëse të skemave të SEPA;

- 2.5. **Skema SEPA** – nënkupton çdo skemë pagese të operuar nga EPC-ja.
- 2.6. **Ligji për bankat** – nënkupton Ligjin nr 08/L-304 për Bankat, dhe/ose ligjin në fuqi për bankat;

Neni 3

Periudha kalimtare për ofruesit e shërbimeve të pagesave

1. Të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave, duke përfshirë bankat, institucionet e pagesave dhe institucionet e parasë elektronike, të licencuar, autorizuar ose regjistruar nga BQK, të cilët synojnë të marrin pjesë në një ose më shumë skema SEPA dhe/ose të ofrojnë transferta SEPA për klientët ose përdoruesit e tyre, duhet të përshtatin plotësisht aktivitetet dhe operacionet në përputhje me dispozitat e pjesëve III dhe IV të Ligjit Nr.10/L-026 për shërbimet e pagesave, të paktën një muaj përpara aplikimit në EPC për pjesëmarrje në një skemë SEPA ose përpara ofrimit ose ekzekutimit të transfertave të kredisë SEPA për klientët ose përdoruesit e tyre.
2. Të gjithë ofruesit e shërbimeve të pagesave të referuar në paragrafin paraprak do të njoftojnë BQK-në paraprakisht për çdo aplikim, ftesë dhe/ose negociim për anëtarësim ose pjesëmarrje në një skemë SEPA.
3. BQK-ja përcakton periudhën kalimtare e lidhur me zbatimin e rregullores përkatëse të aplikueshme për ofruesin e shërbimit të pagesave.

Neni 4

Kërkesa të tjera

Periudha kalimtare dhe detyrimet e përcaktuara në këtë Rregullore nuk cenojnë pajtueshmërinë nga ofruesit e shërbimeve të pagesave me çdo kërkesë, rregull, udhëzim ose kusht të zbatueshëm të EPC ose skemave SEPA për pjesëmarrje në skemat përkatëse SEPA dhe në përputhje me rregullat e zbatueshme të skemës.

Neni 5

Zbatimi, masat përmirësuese dhe ndëshkimet

Çdo shkelje e dispozitave të kësaj Rregulloreje i nënshtrohet masave korrigjuese dhe/ose ndëshkimeve administrative dhe civile, të përcaktuara në nenin 67 të Ligjit Nr. 03/L-209 për Bankën Qendrore të Republikës së Kosovës, të ndryshuar dhe plotësuar me Ligjin Nr. 05/L -150 dhe nenin 125 të Ligjit Nr.10/L-026 për shërbimet e pagesave.

Neni 6

Hyrja në fuqi

Kjo Rregullore hyn në fuqi 15 ditë nga data e miratimit të saj.

Dr.sc. Bashkim Nurboja

Kryetar i Bordit të Bankës Qendrore të Republikës së Kosovës